



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:229752

Datë: 03.01.2025

Numri i dokumentit: 06738383

C.nr.2199/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestuese të iniciuar me padi nga ana e paditësit B.B.-Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me avokatët nga Prishtina, kundër të paditurit Universiteti i Prizrenit “U.H.” në Prizren, me objekt kontesti padi për kompensimin e shujtave (ushqimit), pagës jubilarë dhe 70% të transportit rrugor, vlera e kontestit 11,611.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, në mungesë të palës së paditurës me datë 23.10.2024, ndërsa përpiloi me date 23.11.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.B. nga Prishtina, dhe **DETYROHET** e paditura Universiteti i Prizrenit “U.H.” në Prizren, që paditësit në emër të kompensimit të shujtave ditore për **1,067 ditë** pune gjatë periudhës kohore nga data 13.10.2018 deri me datë 21.11.2022 t’ia kompensoj shumë prej **2,134.00 euro**, në emër të kompensimit të 70% të transportit rrugor për **1,067 ditë** shumë prej **2,560.80. euro**, si dhe në emër të kompensimit të një page jubilarë për 10 vite të përvojës në punë, në vlerë të 50% të një page bazë t’ia kompensoj shumë prej **667.00 euro**, apo shumë e përgjithshme prej **5,361.80 (pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një euro e tetëdhjetë cent)**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë me datë 13.10.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, me të cilën ka kërkuar që të “Obligohet e paditura Universiteti i Prizrenit “U.H.”, që në emër të kompensimit të shujtave ditore për vitin 2017 për 160 ditë pune t’ia paguajë shumë prej 320.00 euro,

për vitin 2018 nga data 01.01.2018 deri më 12.10.2018, për 206 ditë pune t'ia paguajë shumën prej 412.00 euro, për vitin 2022 nga data 22.11.2022 deri më 29.11.2022, për 8 ditë pune t'ia paguajë shumën prej 16.00 euro, si dhe që në emër të kompensimit të 70% të transportit rrugor nga data 01.01.2018 deri më 12.10.2018 për 206 ditë shumën prej 412.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive", **si e pa bazuar.**

III. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumën prej 749.00 euro (shtatëqind e katërdhjetë e nëntë) euro, në afat prej 7 ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë së palës së paditur, konform nenit 423 parag.4 të LPK-së.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi B.B. nga Prishtina, përmes të autorizuarit të tij Studio Ligjore & Financiare "Klinaku" me avokatët nga Prishtina, pranë kësaj gjykate, me datë 13.10.2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Universiteti i Prizrenit "U.H.", me objekt kontesti kompensimin e shujtave (ushqimit), pagave jubilarë dhe 70% e transportit rrugor.

Në referatin e padisë autorizuari i paditësit ka theksuar paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura në vendin e punës rektor i UPZ më tepër se 10 vite. E paditura Universiteti i Prizrenit edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e nënshkruar më 18.04.2017 dhe 22.01.2021, në mes të palëve në marrëveshje si, për SBASHK, për të punësuarin Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dhe për Qeverinë e Kosovës/ Ministria e Arsimit, konform dispozitave të nenit 35 para. 5, 7 dhe 8 të marrëveshjes së cekur, Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe Kontratës individuale nuk ka bërë kompensimin e një page bazë në emër të shpërblimit jubilar, shujtave (ushqimit) për ditët e pranisë në punë me nga 2 euro në ditë prej datës 18.04.2017 deri më ditën e marrjes së aktgjykimit, si dhe kompensimin e 70% të transportit rrugor në ditë për periudhën e lartcekur. Në fund thekson se Universitetit Prizrenit "U.H." është e obliguar që në bazë të fitimit të drejtës së paditësit t'ia paguajë kompensimin e shpërblimit jubilar, shujtave (ushqimit) për ditët e pranisë prej datës 18.04.2017 deri

më ditën e marrjes së aktgjykimit, si dhe kompensimin e 70% të transportit rrugor në ditë për periudhën e lartcekur. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet konform dispozitave (obligative) të Kontratës Kolektive të Arsimit (më konkretisht nenit 35 para.5, 7 dhe 8), Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe kontratës individuale, andaj ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpapia e paditësit.

Me parashtrësën e datës 29.11.2022, e ka bërë precizimin e padisë ashtu që ka kërkuar që detyrohet e paditura Universiteti i Prizrenit "U.H." në Prizren që paditësit në emër të shujtave ditore për 1,440 ditë për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 29.11.2022 t'ia paguajë shumën prej 2,880.00 euro, në emër të kompensimit prej 70% të transportit rrugor t'ia paguajë shumën prej 8,064.00 euro si dhe në emër të kompensimit të pagave jubilarë i takon 50% e pagës bazë në shumën prej 667.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 11,611.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, në nivel vjetor i cili fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë, deri në pagesën definitive, si dhe të obligohet i padituri t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, për padi shumën 104 euro, për precizimin e padisë 104 euro dhe për taksë gjyqësore 21 euro, të gjitha në shumë të përgjithshme prej 229.00 euro, krejt këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

I autorizuari i paditësit së fundmi me parashtrësën e datës 02.04.2024, e ka bërë precizimin e padisë ashtu që ka kërkuar që detyrohet e paditura Universiteti i Prizrenit "U.H." në Prizren që paditësit në emër të shujtave ditore për 2,616 ditë për periudhën kohore nga data 01.01.2017 deri me datë 21.11.2022 t'ia paguajë shumën prej 5,232.00 euro, në emër të kompensimit prej 70% të transportit rrugor t'ia paguajë shumën prej 14,649.60 euro si dhe në emër të kompensimit të pagave jubilarë për 43 vite pune në vlerë të 150% e pagës bazë t'ia paguajë shumën prej 2,002.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 21,883.60 euro, me kamatë ligjore prej 8%, në nivel vjetor i cili fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë, deri në pagesën definitive, si dhe të obligohet i padituri t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, për padi shumën 104 euro, për precizimin e padisë 104 euro dhe për taksë gjyqësore 101 euro, të gjitha në shumë të përgjithshme prej 305.00 euro, krejt këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

E autorizuar e të paditurit B.H. me përgjigjen në padi, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të palejuar, për faktet se neni 35 të Kontratës Kolektive paragrafi 5 përcakton se Punonjësit arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70 % e shpenzimeve të transportit urban. Sipas kësaj dispozite, e paditura thekson se paditësit nuk i takon kjo e drejtë pasi që paditësi është banor i rregullt në Malishevë, e që nënkupton se i njëjti nuk është banor i Komunës së Prizrenit ku edhe është selia e Universitetit të Prizrenit. Në vazhdim ka theksuar se dëshmitë të cilat janë prezantuar si vërtetim i çmimit të biletës lëshuar nga SH.T.U. në emër të S.G. në cilësinë e kryetarit, nuk qëndrojnë dhe

nuk janë fakte që mund të provojnë realizimin e shpenzimeve të udhëtimit. Kërkesë për kompensimin të transportit është në kundërshtim me Ligjin për Financa Publike, pasi që kompensimi ndaj paditësit i cili pretendon se i takon nuk është deklaruar nga financat e Universitetit asnjëherë si borxh andaj si e tillë nuk ekziston. Referuar dispozitave ligjore përkatësisht dispozitat e LPK-së çështja e këtij objekti të shqyrtimit ligjor është parashkruar. Po ashtu duhet të theksohet se shpërblimi jubilar nuk mund të jepet pasi që kjo do të kishte implikime të mëdha buxhetore. Paditësi ka qenë në marrëdhënie të rregullt punë në Universitetin "U.H." në Prizren që nga viti 2014, fillimisht si profesor asistent, për tu avancuar në thirrjen profesor i asocuar i cili asnjëherë nuk ka qenë rektor i universitetit ashtu siç është deklaruar. Gjithashtu, mbetet kontestuese sa i përket dokumentet në cilësinë e provës, si jo relevante të cilat nuk i plotësojnë elementet e një dokumenti zyrtar. Ka theksuar se pala paditëse nuk ka shterur mjetet juridike të brendshme për realizimin e kërkesës së tij. Kërkesëpadinë po ashtu e ka kontestuar sa i përket ditëve të pranisë në punë të paditësit, me pretendimet se mësimi në vitin 2020 dhe 2021 në përputhje me situatën e krijuar nga pandemia covid-19, mësimi është mbajtur me platformën online pa prani fizike në vendin e punës, ashtu që paditësi nuk ka prezantuar fizikisht në punë. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

I autorizuari i paditësit av. S.K. në seancën përgaditore edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, po ashtu edhe pas parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv të datës 29.11.2022, respektivisht 05.04.2023. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesin në tërësi sipas precizimit të dorëzuar të datës 29.11.2022, respektivisht 05.04.2023, duke konsideruar që pas administrimit të provave janë vërtetuar faktet vendimtare lidhur me kërkesë padinë e paditësit, prandaj kërkojnë nga gjykata që të nxjerrë aktgjykim në mënyrë që ta aprovoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke e detyruar të paditurën që në emër të kompensimit të shujtave ditore, pagave jubilarë dhe transportit rrugor paditësit të i paguaj shumën e përgjithshme prej 11,611 euro dhe atë me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë për tre përfaqësime në tri seancë me nga 270.00 euro për secilën, për padisë shumën 208.00 euro, për precizimin e padisë 208.00 euro dhe për taksë gjyqësore 21 euro, të gjitha në shumë të përgjithshme prej 1,247.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

E autorizuar e të paditurit B.H. në seancën përgaditore ka deklaruar se mbetet në tërësi si në përgjigje në padi si dhe gjatë seancës së sotme deklaroi se paditësi ka bërë padi për kompensimin e shujtës ditore, transportit rrugor dhe pagave jubilarë, të gjitha këto janë të pa bazuara sepse kompensimi i shujtave sipas parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë llogaritja e tyre nuk është vërtetuar, sa i përket transportit rrugor prej 70%, paditësit nuk i takon pasi që të gjithë e dinë se i njëjti në punë ka ardhur me

veturë personale dhe se i njëjti me vendbanim është në Prizren. Gjithashtu fakt shumë me rëndësi është edhe vërtetimi i prezantuar nga kompania e autobusëve i cili nuk është dokument zyrtarë, andaj i ka propozuar gjykatës që të hedhet poshtë si e pajuar në tërësi padia e paditësit dhe të detyrohet paditësi që t'i paguajë të paditurit të gjitha shpenzimet e shkaktuara. Në fjalën përfundimtare të cilën gjykatës ia ka dorëzuar me shkrim ka theksuar se e kundërshtojnë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pajuar, për faktet se neni 35 të Kontratës Kolektive paragrafi 5 përcakton se Punonjësit arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70 % e shpenzimeve të transportit urban. Sipas kësaj dispozite, e paditura thekson se paditësit nuk i takon kjo e drejtë pasi që paditësi është banor i rregullt në Malishevë, e që nënkupton se i njëjti nuk është banor i Komunës së Prizrenit ku edhe është selia e Universitetit të Prizrenit. Në vazhdim ka theksuar se dëshmitë të cilat janë prezantuar si vërtetim i çmimit të biletës lëshuar nga SH.T.U. në emër të S.G. në cilësinë e kryetarit, nuk qëndrojnë dhe nuk janë fakte që mund të provojnë realizimin e shpenzimeve të udhëtimit. Kërkesë për kompensimin të transportit është në kundërshtim me Ligjin për Financa Publike, pasi që kompensimi ndaj paditësit i cili pretendon se i takon nuk është deklaruar nga financat e Universitetit asnjëherë si borxh andaj si e tillë nuk ekziston. Referuar dispozitave ligjore përkatësisht dispozitat e LPK-së çështja e këtij objekti të shqyrtimit ligjor është parashkruar. Po ashtu duhet të theksohet se shpërblimi jubilar nuk mund të jepet pasi që kjo do të kishte implikime të mëdha buxhetore. Paditësi ka qenë në marrëdhënie të rregullt punë në Universitetin "U.H." në Prizren që nga viti 2014, fillimisht si profesor asistent, për tu avancuar në thirrjen profesor i asocuar i cili asnjëherë nuk ka qenë rektor i universitetit ashtu siç është deklaruar. Gjithashtu, mbetet kontestuese sa i përket dokumentet në cilësinë e provës, si jo relevante të cilat nuk i plotësojnë elementet e një dokumenti zyrtar. Ka theksuar se pala paditëse nuk ka shterur mjetet juridike të brendshme për realizimin e kërkesës së tij. Kërkesëpadinë po ashtu e ka kontestuar sa i përket ditëve të pranisë në punë të paditësit, me pretendimet se mësimi në vitin 2020 dhe 2021 në përputhje me situatën e krijuar nga pandemia covid-19, mësimi është mbajtur me platformën online pa prani fizike në vendin e punës, ashtu që paditësi nuk ka prezantuar fizikisht në punë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat si në vijim: kontratat e punës me numër të protokollit 06-254, të datës 21.08.2022 dhe me numër të protokollit 06-116/03, të datës 25.01.2018, vërtetimin me nr.01-357, të datës 12.07.2021, vërtetimin e lëshuar nga SHTU, të datës 27.09.2021, ekstraktin e lindjes për paditësin B.B. vërtetimin me nr. 01-112, i datës 06.03.2024, çertifikatën e vendbanimit për paditësin B.B. vërtetimin me numër rendon 01-xxx, i datës 25.11.2022.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pjesërisht themeltë.

Nga kontrata e punës me numër të protokollit 06-125, të datës 02.05.2018, gjykata vërtetoi se paditësi B.B. ka krijuar marrëdhënie pune më të paditurën Universiteti i Prizrenit "U.H.", në Prizren në vendin e punës me titull profesor i asocuar nga data 20.04.2018 deri më 19.04.2022.

Nga kontrata e punës me numër të referencës 1/EK-2014, gjykata vërtetoi se paditësi B.B. ka krijuar marrëdhënie pune më të paditurën Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", në Prizren në vendin e punës me titull profesor asistent nga data 01.04.2014 deri më 01.04.2018.

Nga leximi i vërtetimit të lëshuar nga Universiteti "U.H." në Prizren, Fakulteti Ekonomik, me numër të referencës 01-357, të datës 12.07.2021, gjykata vërtetoi se paditësi ka filluar punën në Fakultetin Ekonomik në Universitetin "U.H." në Prizren nga viti 2010 si profesor i angazhuar, kurse në marrëdhënie të rregullt pune profesor asistent ka filluar me datë 12.02.2014 me pagë bazë 1182.62 euro, kurse është zgjedhur profesor i asocuar me datë 20.04.2018 me pagë bazë 1334.67 euro, gjithsej vite pune në UPZ janë 10 vite, ndërsa jashtë UPZ ka gjithsej 34 vite përvojë pune.

Nga leximi i vërtetimit të lëshuar nga SH.T.U. për B.B. të datës 27.09.2021, gjykata vërtetoi se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Prizren - Prishtinë dhe Prishtinë - Prizren, ka qenë 4.00 euro në një drejtim.

Nga leximi i vërtetimit të lëshuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, Fakulteti Ekonomik, me numër të referencës 03/112, të datës 06.03.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi në vitin 2017 ka qenë 262 ditë prezentë në punë, në vitin 2018 ka qenë 261 ditë prezentë në punë, në vitin 2019 ka qenë 261 ditë prezentë në punë, në vitin 2020 ka qenë 262 ditë prezentë në punë, 2021 ka qenë 262 ditë prezentë në punë dhe 2022 ka qenë 262 ditë prezentë në punë.

Nga leximi i çertifikatës së vendbanimit, me numër serik B 10385408, të datës 02.06.2022, gjykata vërtetoi se paditësi e ka vendbanim në Prishtinë, kurse vendqëndrimin në Prizren.

Nga leximi i vërtetimit të lëshuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, Fakulteti Ekonomik, me numër të referencës 01-XXX, të datës 25.11.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi në vitin 2017 ka qenë 260 ditë prezentë në punë, në vitin 2018 ka qenë 260 ditë prezentë në punë, në vitin 2019 ka qenë 260 ditë prezentë në punë, në vitin 2020 ka qenë 260 ditë prezentë në punë, 2021 ka qenë 260 ditë prezentë në punë dhe 2022 ka qenë 260 ditë prezentë në punë.

Baza Ligjore

Me nenin 35 para. 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të vitit 2017 dhe 2021 është paraparë se *"Punonjësve arsimorë(anëtarë të SBASHK-ut) që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban"*. Me nenin 35 para. 7 është paraparë se *"Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim"*, ndërsa me nenin 35 par.8, nën par.8.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është paraparë se *"Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: "për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë"*. Me nenin 7.1 të LPK-së përcaktohet se *"Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla."* Neni 341 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje si LMD) përcakton se *"Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë"*, ndërsa me nenin 342 të LMD-së, parashihet që *"Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër"*. Neni 87 të Ligjit të Punës përcakton që *"të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës"* Edhe në nenin 319.1 të LPK-së rezulton kërkesa që *"Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, ndërsa me nenin 322 paragrafi 2 të LPK-së parashihet se "Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër"*.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Nga provat e administruara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe se njëjta duhet të refuzohet në tërësi, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si profesor i asocuar në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren e që ky fakt gjen edhe mbështetje në bazë të kontratave të punës me numër të protokollit 06-254 të datës 21.08.2022 dhe me numër të protokollit 06-116-03, të datës 25.01.2021, vërtetimeve të lëshuar nga Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, Fakulteti Juridik, me numër të referencës 03-162, të datës 29.05.2023 dhe me numër të referencës 03/287, të datës 10.10.2023. Kontestuese ishte nëse paditësit i takon kompensimi për shujtat ditore, për 70% të transportit rrugor si dhe kompensimi i pagave jubilarë.

Në këtë drejtim, gjykata vendosi sikurse në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e aprovuar pjesërisht kërkesën e palës paditëse që në emër të kompensimit të shujtave ditore për **1,067 ditë** pune gjatë periudhës kohore nga data 13.10.2018 deri me datë 21.11.2022 t’ia kompensoj shumën prej **2,134.00 euro**, në emër të kompensimit të 70% të transportit rrugor për **1,067 ditë** shumën prej **2,560.80. euro**, si dhe në emër të kompensimit të një page jubilarë për 10 vite të përvojës në punë, në vlerë të 50% të një page bazë t’ia kompensoj shumën prej **667.00 euro**, apo shumën e përgjithshme prej **5,361.80** dhe atë duke u bazuar në kontratat e punës dhe vërtetimet e lartcekura e të cilat gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të Nenit 329 par.1 të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”, Andaj meqë këto janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, ashtu që, vërtetimet e lëshuara nga ana e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, si provë me të cilat vërtetohen faktet lidhur me ditët e pranisë në punë të paditësit dhe faktet lidhur me përvojën në punë, ndërsa nga vërtetimi i datës 27.09.2021, gjykata vërtetoi çmimin e biletave të transportit të cilin e ka shfrytëzuar paditësi për udhëtimin e tij gjatë ditëve të punës, gjykata ia fali besimin e plotë. Andaj në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si profesor t’ia paguaj kompensimin e shujtave ditore, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës, duke i njohur shumën si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për

përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit B.B. gjykata ka vendosur si në pikën nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar kërkesën e palës paditëse sa i përket kompensimit të shujtave ditore për vitin 2017 për 160 ditë pune t'ia paguajë shumën prej 320.00 euro, për vitin 2018 nga data 01.01.2018 deri më 12.10.2018, për 206 ditë pune t'ia paguajë shumën prej 412.00 euro, si dhe që në emër të kompensimit të 70% të transportit rrugor nga data 01.01.2018 deri më 12.10.2018 për 206 ditë shumën prej 412.00 euro, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës shprehimisht theksohet që "të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës". Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 13.10.2021. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 12.10.2018, me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 13.10.2021 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 13.10.2018 e deri më 21.11.2022. Ndërsa gjykata e ka refuzuar kërkesën e paditësit për vitin 2022 nga data 22.11.2022 deri më 29.11.2022, për 8 ditë pune t'ia paguajë shumën prej 16.00 euro, për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit ka qenë në fuqi deri me datën 21.11.2022, ndërsa pas kësaj date nuk ka qenë në zbatueshmëri. Po ashtu sipas llogaritjes së gjykatës nëse 1440 ditë shumëzohen me 8 euro çmimi i biletës del shuma 11,520.00 euro minus 70% të kësaj shume del vlera 3,456.00 euro dhe jo 8,064.00 euro

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kumatën ligjore si në dispozitiv të bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë 13.10.2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kumatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.265/2020 të dt.02.12.2020, pasi që në rastin konkret, i padituri, është vonuar në përmbushjen e detyrimit ndaj paditësit.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet dhe atë për përfaqësimin në 3 seanca gjyqësore (208x2 dhe 1 seancë 208 x 50% =104 euro) apo shumën prej 520.00 euro, për përpilimin e padisë në shumën prej 208.00 euro, për taksën gjyqësore shumën prej 21.00 euro, gjithsej shumën prej 749.00 euro, ndërsa gjykata e ka refuzuar shumën prej 104.00 apo 50% për përfaqësim pasi që seanca e datës 05.09.2024 është shtyrë, po ashtu gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, pasi që kompensimi caktohet

vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar sipas aktvendimit për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2199/2021, me datë 23.11.2024

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate